Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 16
Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)

Objektivi

1 Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë trajtimin kontabël për aktivet afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), në këtë mënyrë përdoruesit e pasqyrave financiare mund të dallojnë informacionin që lidhet më investimet e një njësie ekonomike në aktive afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) dhe ndryshimet që ndodhin në investime të tilla. Çështjet kryesore në kontabilitetin e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) janë njohja e aktiveve, përcaktimi i vlerave kontabël (neto) dhe shumave të amortizimit dhe humbjeve nga zhvlerësimi që do të njihen lidhur me to.

Objekti

2 Ky Standard do të zbatohet për kontabilitetin e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) me përjashtim të rastit kur një Standard tjetër kërkon ose lejon një trajtim kontabël të ndryshëm.

3 Standardi nuk zbatohet për:

(a) aktivet materiale afatgjata (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të klasifikuara si të mbajtura për shitje në përputhje me SNRF 5 *Aktive afatgjata të mbajtura për shitje dhe operacionet jo-të vijueshme.*

(b) aktivet biologjike në lidhje me veprimtarinë bujqësore (shih SNK 41 *Bujqësia*); Ky Standard zbatohet për bimët bartëse, por kjo nuk zbatohet për prodhimin e bimëve bartëse.

(c) njohjes dhe matjes së aktiveve të kërkimit dhe vlerësimit (shih SNRF 6 *Kërkimet për burime minerare dhe vlerësimi i tyre);*

(d) të drejtat minerare dhe rezervat minerale, të tilla si nafta, gazi natyror dhe burime jo rigjeneruese të ngjashme.

Megjithatë ky Standard zbatohet për aktivet afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të përdorura për të zhvilluar ose mbajtur aktivet e përshkruara në (b)–(d).

4 [Fshirë]

5 Njësia ekonomike që përdor modelin e kostos për aktivin afatgjatë material të investuar në përputhje me SNK 40 *Aktivet afatgjata materiale të investuar*a duhet të përdorë modelin e kostos në këtë Standard për aktivin afatgjatë material të investuar të zotëruar.

Përkufizimet

6 Termat e mëposhtëm janë përdorur në këtë Standard sipas këtyre kuptimeve specifike:

Një *bimë bartëse* është një bimë e gjallë e cila:

(a) përdoret në prodhimin ose ofrimin e prodhimit bujqësor;

(b) pritet që të japë prodhim gjatë më shumë se një periudhe; dhe

(c) ka pak shanse të shitet si prodhim bujqësor, me përjashtim të shitjes aksidentale si mbeturinë.

(Paragrafët 5A–5B të SNK 41 sqarojnë përkufizimin e një bime bartëse.)

***Vlerë kontabël (neto)* është shuma me të cilën një aktiv njihet pasi janë zbritur në atë kohë çdo amortizim i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga zhvlerësimi.**

***Kosto* është shuma e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare të paguara ose vlera e drejtë e shumës së dhënë për të blerë një aktiv në momentin e blerjes ose ndërtimit të tij, ose, kur është e zbatueshme, shuma që i atribuohet atij aktivi kur njihet fillimisht në përputhje me kërkesat specifike të SNRF-ve të tjera, p.sh., SNRF 2 *Pagesat e Bazuara në Aksione*.**

Shumë e amortizueshme **është kosto e një aktivi, ose shumë tjetër zëvendësuese e kostos, minus vlerën e tij të mbetur.**

Amortizimi **është shpërndarja sistematike e shumës së amortizueshme të një aktivi gjatë jetës së tij të dobishme.**

Njësia ekonomike-vlera specifike **është vlera aktuale e flukseve monetare që njësia ekonomike pret të vijnë nga përdorimi në vazhdimësi i një aktivi dhe nga nxjerrja e tij jashtë përdorimit në fund të jetës së tij të dobishme ose pret të paguajë kur shlyen një detyrim.**

Vlera e drejtë **është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. (Shih SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë*.)**

Një *humbje nga zhvlerësimi* është shuma me të cilën vlera kontabël (neto) e një aktivi tejkalon shumën e tij të rikuperueshme.

Toka, ndërtesa, makineri e pajisje **janë zëra materialë që:**

(a) mbahen për përdorim në prodhimin ose furnizimin e të mirave ose shërbimeve, për dhënie me qira të tretëve ose për qëllime administrative; dhe

(b) pritet që të përdoren gjatë më shumë se një periudhe.

Shuma e rikuperueshme **është më e madhja ndërmjet çmimit neto te shitjes së aktivit dhe vlerës së tij në përdorim.**

Vlera e mbetur **e një aktivi është shuma e vlerësuar që një njësi ekonomike mundet aktualisht të marrë nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktivit, pasi zbriten kostot e vlerësuara të nxjerrjes jashtë përdorimit, nëse aktivi ka qenë tashmë në afatin dhe në kushtet e pritura në fund të jetës së tij të dobishme.**

Jeta e dobishme **është:**

(a) periudha gjatë së cilës një aktiv pritet të jetë i disponueshëm për përdorim nga njësia ekonomike; ose

(b) sasia e prodhimit apo njësive të ngjashme që priten të merren nga aktivi prej njësisë ekonomike.

Njohja

7 Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) do të njihet si aktiv nëse dhe vetëm nëse:

(a) është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe

(b) kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

8 Zëra të tillë si pjesët e ndërrimit, pajisjet e palëvizshme dhe pajisjet e shërbimit njihen në përputhje me këtë SNRF kur ato plotësojnë përkufizimin si aktive afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje). Në të kundërt të tillë zëra klasifikohen si inventar.

9 Ky Standard nuk përshkruan njësinë e matjes për njohje, d.m.th. çfarë përbën një zë të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje). Prandaj kërkohet përdorimi i gjykimit për zbatimin e kriterit të njohjes në rrethanat specifike të një njësie ekonomike. Mund të jetë e përshtatshme të grumbullohen zëra individualë të parëndësishëm të tillë si forma, vegla e stampa dhe zbatimin e kriterit për vlerën totale.

10 Njësia ekonomike vlerëson sipas parimit të përgjithshëm të njohjes të gjitha kostot e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) në momentin që ato ndeshen (krijohen). Këto kosto përfshijnë kostot e pësuara (kryera) fillimisht për të blerë ose ndërtuar një zë të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) dhe kostot e krijuara më pas për të shtuar, zëvendësuar ose shërbyer një zë. Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) mund të përfshijë kostot e pësuara gjatë dhënies me qira të aktiveve që janë përdorur për të ndërtuar, për të shtuar, për të zëvendësuar pjesë të ose për t'i shërbyer një zëri të aktiveve afatgjata materiale, si për shembull amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorimi.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Kostot fillestare

11 Zërat e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) mund të blihen për arsye sigurie ose mjedisore. Blerje e aktiveve afatgjata materiale të tilla (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) megjithëse nuk rrit në mënyrë direkte përfitimet ekonomike të ardhshme të një zëri ekzistues të veçantë të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), mund të jetë e nevojshme që njësia ekonomike të marrë përfitime ekonomike të ardhshme nga aktivet e tjera të saj. Zëra të tillë të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) kualifikohen për njohjen si aktive sepse ata i mundësojnë një njësie ekonomike të nxjerrë përfitime ekonomike të ardhshme nga aktivet e lidhura më të mëdha sesa do të mund të nxirreshin nëse këto zëra nuk do të ishin blerë. Për shembull një prodhues i lëndëve kimike mund të instalojë një proces të ri të trajtimit të lëndëve kimike për të plotësuar kërkesat mjedisore për prodhimin dhe ruajtjen e lëndëve kimike të rëndësishme; zgjerimet përkatëse të uzinës njihen si aktiv sepse pa to njësia ekonomike nuk është në gjendje të prodhojë dhe shesë lëndë kimike. Megjithatë vlera kontabël (neto) që rezulton nga një aktiv i tillë dhe aktivet e lidhura rishikohet për zhvlerësim në përputhje me SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve*.

Kostot vijuese

12 Sipas parimit të njohjes në paragrafin 7, një njësi ekonomike nuk njeh në vlerën kontabël (neto) të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) kostot e shërbimit ditor të zërit. Kështu, këto kosto njihen në fitim ose humbje kur ato kryhen. Kostot e shërbimit ditor kryesisht janë kosto të punës dhe të konsumueshme dhe mund të përfshijnë koston e pjesëve të vogla. Qëllimi i këtyre shpenzimeve shpesh përshkruhet si për 'riparime dhe mirëmbajtje' të zërit të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).

13 Pjesë të disa zërave të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) mund të kërkojë zëvendësimin në intervale të rregullta. Për shembull një furrnaltë mund të kërkojë riveshje pas një numri orësh përdorimi, ose ambienti i brendshëm i një avioni si karriget dhe kuzhina mund të duhet të zëvendësohen disa herë gjatë jetës së skeletit të avionit. Zëra të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) mund të blihen edhe për të bërë më rrallë zëvendësimin e përsëritur të tillë si zëvendësimi i mureve të brendshme të një ndërtese ose për të mos bërë një zëvendësim të përsëritur. Sipas parimit të njohjes në paragrafit 7, një njësi ekonomike njeh në vlerën kontabël (neto) të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) koston e zëvendësimit të pjesës së një zëri të tillë kur kjo kosto ndodh nëse plotësohet kriteri i njohjes. Vlera kontabël (neto) e këtyre pjesëve që zëvendësohen nuk njihet në përputhje me kushte për mosnjohje të këtij Standardi (shih paragrafët 67–72).

14 Një kusht i vijueshmërisë së shfrytëzimit të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje (për shembull një avion)) mund të jetë kryerja e inspektimeve të rregullta kryesore për gabime pavarësisht nëse pjesët e zërit janë zëvendësuar. Kur çdo inspektim kryesor është kryer, kostoja e tij njihet në vlerën kontabël të zërit toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje, si një zëvendësim nëse janë plotësuar kriteret e njohjes. Çdo vlerë kontabël (neto) e mbetur e kostos së inspektimit të mëparshëm (e dallueshme nga pjesët fizike) nuk njihet. Kjo ndodh pavarësisht nëse kosto e inspektimit të mëparshëm ishte identifikuar në transaksionin në të cilin ishte blerë ose ndërtuar zëri. Nëse është e nevojshme kosto e vlerësuar e inspektimeve të ngjashme të ardhshme mund të përdoret si një tregues sesa ishte kosto e përbërësit ekzistues të inspektimit kur u ble ose u ndërtua zëri.

Matja dhe Njohja

15 Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) që kualifikohet për njohje si aktiv do të matet me koston e tij.

Elementët e kostos

16 Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) përfshin:

(a) çmimin e tij të blerjes, përfshirë taksat doganore dhe taksat mbi blerjen jo të rimbursueshme, pasi zbriten skontot tregtare dhe zbritjet tregtare.

(b) çdo kosto të ngarkueshme drejtpërdrejtë për të sjellë aktivin në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi.

(c) vlerësimin fillestar të kostove të zbërthimit dhe heqjes së zërit dhe restaurimi i vendit në të cilin ai është vendosur, detyrimin për të cilën një njësi ekonomike ekspozohet ndaj një detyrimi të tillë

ose kur zëri sigurohet ose si pasojë e përdorimit të tij (zërit) gjatë një periudhe të caktuar për qëllime të ndryshme nga prodhimi i inventarëve gjatë asaj periudhe.

17 Shembuj të kostove drejtpërdrejt të atribueshme janë:

(a) kostot e përfitimeve të punonjësve (siç përcaktohet në SNK 19 *Përfitimet e punonjësve*) që vijnë drejtpërdrejt nga ndërtimi ose blerja e zërit të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje);

(b) kostot e përgatitjes së vendit;

(c) kostot e lëvrimit dhe transportit fillestar;

(d) kostot e vënies në punë dhe bashkimit;

(e) kostot e testimit nëse aktivi funksionon siç duhet (p.sh. vlerësimi nëse performanca teknike dhe fizike e aktivit është e tillë që është në gjendje të përdoret në procesin e prodhimit ose të furnizimit me mallra ose shërbime, për t'u dhënë me qira tek të tjerët, ose për qëllime administrative); dhe

(f) tarifat profesionale.

18 Një njësi ekonomike zbaton SNK 2 *Inventarët* për kostot e detyrimeve për zbërthimin, lëvizjen dhe restaurimin e vendit në të cilin vendoset zëri, të cilat ndodhin gjatë një periudhe të caktuar si pasojë e përdorimit të zërit për të prodhuar inventarë gjatë kësaj periudhe. Detyrimet për kostot e trajtuara në përputhje me SNK 2 ose SNK 16 njihen dhe maten në përputhje me SNK 37 *Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara.*

19 Shembuj të kostove që nuk janë kosto e zërit të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) janë:

(a) kostot të hapjes së një reparti të ri;

(b) kostot e prezantimit të një produkti ose shërbimi të ri (duke përfshirë kostot e reklamimit dhe aktiviteteve promovuese);

(c) kostot e kryerjes së biznesit në një vend të ri, ose me një klasë të re të konsumatorëve (duke përfshirë kostot e trajnimit të stafit); dhe

(d) kostot e administrimit dhe kosto të tjera të përgjithshme.

20 Njohja e kostove në vlerën kontabël (neto) të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) ndërpritet kur zëri është në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë në gjendje të shfrytëzohet në mënyrën e synuar nga drejtimi. Për këtë, kostot e pësuara në përdorimin apo ridisalokimin i një zëri nuk përfshihen në vlerën kontabël (neto) të atij aktivi. Për shembull kostot në vijim nuk përfshihen në vlerën kontabël (neto) të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje):

(a) kostot e ndodhura ndërkohë që një zë i aftë për t'u shfrytëzuar në mënyrën e synuar nga drejtimi, nuk është përdorur ende ose nuk shfrytëzohet me kapacitet të plotë;

(b) humbjet operacionale fillestare, të tilla si ato të pësuara kur kërkesa për produktet e aktivit rritet; dhe

(c) shpenzimet për dislokimin ose riorganizimin e një pjese ose të gjithë njësisë ekonomike.

20A Gjatë procesit të sjelljes së një zëri të aktiveve afatgjata materiale në vendndodhjen dhe gjendjen e nevojshme që ai të jetë i aftë të funksionojë në mënyrën e parashikuar nga drejtimi, mund të prodhohen artikuj të ndryshëm (siç janë mostrat e prodhuara gjatë testimit, nëse aktivi funksionon siç duhet). Një njësi ekonomike njeh të ardhurat nga shitja e zërave të tillë dhe kostot e atyre zërave, në fitim ose humbje, në përputhje me Standardet në fuqi. Njësia ekonomike mat koston e atyre zërave duke zbatuar kërkesat e matjes sipas SNK 2.

21 Disa veprime ndodhin në lidhje me ndërtimin ose zhvillimin e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) por nuk janë të domosdoshme për të sjellë zërin në vendndodhje dhe në kushtet e nevojshme që ai të jetë në gjendje për t'u shfrytëzuar në mënyrën e synuar nga drejtimi. Këto veprimtari rastësore mund të ndodhin para ose gjatë veprimtarive të zhvillimit. Për shembull mund të fitohen të ardhura nga përdorimi i një sheshi ndërtimi si një park për makinat derisa të fillojnë punimet. Për arsye se veprimtaritë rastësore nuk janë të nevojshme për ta sjellë aktivin në kushtet e nevojshme për të qenë në gjendje që të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi, të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura me veprimtaritë rastësore njihen në fitim ose humbje dhe përfshihen në klasifikimet e tyre përkatëse të të ardhurave dhe të shpenzimeve.

 © Fondacioni i SNRF-ve

22 Kosto e një aktivi të krijuar vetë përcaktohet duke përdorur të njëjtat parime si për blerjen e një aktivi. Nëse një njësi ekonomike krijon aktive të ngjashme për shitje gjatë rrjedhës normale të biznesit, kosto e aktivit zakonisht është e njëjtë si kosto e ndërtimit të një aktivi për shitje (shih SNK 2). Prandaj çdo fitim i brendshëm eliminohet në përcaktimin e kostove të tilla. Në mënyrë të ngjashme kosto e shumave jo-normale të materialeve, punës ose burimeve të tjera të humbura (skarco) të ndodhura gjatë ndërtimit të vetë të aktivit nuk përfshihet në koston e aktivit. SNK 23 *Kostot e huamarrjes* vendos kriteret për njohjen e interesit si përbërës për vlerën kontabël (neto) të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të ndërtuar vetë.

22A Para se të vendosen në zonën dhe kushtet e nevojshme për t'u përdorur sipas synimit të drejtimit të njësisë ekonomike, bimët bartëse trajtohen në të njëjtë mënyrë si zërat e ndërtuar vetë të aktiveve afatgjata materiale. Për pasojë, referencat ndaj 'ndërtimit' në këtë Standard duhet të lexohen si mbulues të aktiviteteve të nevojshme për kultivimin e bimëve bartëse para se ato të vendosen në zonën dhe kushtet e nevojshme për t'u përdorur sipas synimit të drejtimit të njësisë ekonomike.

Matja e kostos

23 Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) është ekuivalent i çmimit në mjete monetare në datën e njohjes. Nëse pagesa shtyhet përtej kushteve normale të kredisë diferenca mes ekuivalentit të çmimit në mjete monetare dhe totalit të pagesave, njihet si interes gjatë periudhës së kredisë me përjashtim të rastit kur interesi i tillë njihet në vlerën kontabël (neto) të zërit në përputhje me trajtimin alternativ të lejuar në SNK 23.

24 Një ose më shumë zëra të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) mund të blihen në këmbim të një aktivi jo-monetar ose aktiveve ose një kombinim i aktiveve monetare ose jo-monetare. Diskutimi i mëposhtëm i referohet thjesht një këmbimi të një aktivi jo-monetar me një tjetër, por ai gjithashtu zbatohet për të gjitha këmbimet e përshkruara në fjalinë e mëparshme. Kosto e një zëri të tillë të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) matet me vlerën e drejtë përveç se kur (a) transaksioni i këmbimit nuk ka thelb tregtar ose (b) vlera e drejtë qoftë e aktivit të marrë qoftë e aktivit të dhënë nuk është e matshme me besueshmëri. Zëri i blerë matet në këtë mënyrë edhe nëse njësia ekonomike nuk mundet që ta çregjistrojë menjëherë aktivin e dhënë. Nëse zëri i blerë nuk matet me vlerën e drejtë, kosto e tij matet me vlerën kontabël (neto) të aktivit të dhënë.

25 Njësia ekonomike përcakton nëse një transaksion këmbimi ka përmbajtje tregtare duke marrë parasysh se në ç'masë pritet të ndryshojnë flukset e ardhshme të mjeteve monetare si rezultat i tij. Një transaksion këmbimi ka thelb tregtar nëqoftëse:

(a) konfigurimi (rreziku, koha dhe shuma) i flukseve monetare të aktivit të marrë ndryshon nga konfigurimi i flukseve monetare të aktivit të transferuar; ose

(b) njësia ekonomike - vlera specifike e një pjese të operacioneve të njësisë ekonomike të ndikuar nga transaksioni ndryshon si rezultat i këmbimit; dhe

(c) diferenca në (a) ose (b) është e ndjeshme në lidhje me vlerën e drejtë të aktiveve të këmbyera.

Me qëllim përcaktimin nëse një transaksion këmbimi ka përmbajtje tregtare, vlera specifike e njësisë ekonomike për pjesën e veprimtarive të saj, e prekur nga transaksioni, do të pasqyrojë flukset e mjeteve monetare pas tatimit. Rezultati i këtyre analizave mund të jetë i qartë pa pasur nevojë që njësia ekonomike të kryejë llogaritje të hollësishme.

26 Vlera e drejtë e një aktivi për të cilin nuk ekzistojnë transaksione tregu të krahasueshme matet me besueshmëri nëqoftëse (a) ndryshimet në gamën e vlerave të drejta të arsyeshme nuk janë të rëndësishme për atë aktiv ose (b) mundësitë e vlerësimeve të ndryshme brenda gamës mund të vlerësohen arsyeshëm dhe të përdoren në vlerësimin e vlerës së drejtë. Nëse një njësi ekonomike ka mundësi të përcaktojë me besueshmëri vlerën e drejtë ose të aktivit të marrë ose të aktivit të dhënë, atëherë vlera e drejtë e aktivit të dhënë përdoret për të matur koston e aktivit të marrë përveç rastit kur vlera e drejtë e aktivit të marrë është shumë më e qartë.

27 [Fshirë]

28 Vlera kontabël (neto) e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) mund të pakësohet nga grantet qeveritare në përputhje me SNK 20 *Kontabiliteti i granteve qeveritare dhe paraqitja e informacioneve për ndihmën qeveritare.*

Matja pas njohjes

29 **Një njësi ekonomike do të zgjedhë ose modelin e kostos në paragrafin 30 ose modelin e rivlerësimit në paragrafin 31 si politikë kontabël të vet dhe do të zbatojë këtë politikë për të gjithë kategorinë e aktiveve afatgjata materiale.**

29A Disa njësi ekonomike menaxhojnë, nga brenda ose nga jashtë, fonde investimesh të cilat u ofrojnë investitorëve përfitime të përcaktuara nga njësitë në fond. Në mënyrë të ngjashme disa njësi ekonomike emetojnë grupe të kontratave të sigurimit me tipare të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë dhe mbajnë zërat bazë. Disa nga këto fonde ose zëra bazë përfshijnë pasuri të zotëruar nga pronari. Njësia ekonomike zbaton SNK 16 për pasuritë e zotëruara nga pronari, të cilat përfshihen në një fond të tillë ose në zërat bazë. Pavarësisht nga paragrafi 29, njësia ekonomike mund të zgjedhë të masë pasuri të tilla duke përdorur modelin e vlerës së drejtë në përputhje me SNK 40. Për shkak të kësaj zgjedhjeje, kontratat e sigurimit përfshijnë kontrata investimi me tipare të pjesëmarrjes së lirë. (Shih SNRF 17 *Kontratat e sigurimit* për termat e përdorur në këtë paragraf dhe të përkufizuar në atë Standard.)

29B Njësia ekonomike do të trajtojë pasurinë e zotëruar nga pronari, të matur sipas modelit të vlerës së drejtë për aktivin afatgjatë material të investuar duke zbatuar paragrafin 29A, si një kategori të veçantë të aktiveve afatgjata materiale.

Modeli i kostos

30 **Mbas njohjes fillestare si një aktiv, një zë i aktiveve afatgjata materiale mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.**

Modeli i rivlerësimit

31 **Pas njohjes si një aktiv, një zë i aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) vlera e drejtë e të cilëve matet me besueshmëri do të mbartet me shumën e rivlerësuar, që është vlera e drejtë e zërave në datën e rivlerësimit minus ndonjë amortizim të mëpasshëm të akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësim. Rivlerësimet do të bëhen në mënyrë të rregullt të mjaftueshme që të sigurohet se vlera kontabël (neto) e aktivit nuk ndryshon materialisht nga ajo që do të përcaktohej nëse do të përdorej vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese.**

32-33 [Fshirë]

34 Frekuenca e rivlerësimit varet nga ndryshimet në vlerën e drejtë të zërave të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) që rivlerësohen. Nëse vlera e drejtë e një aktivi të rivlerësuar ndryshon materialisht nga vlera e tij kontabël (neto), është i nevojshëm një rivlerësim i mëtejshëm. Disa zëra të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) pësojnë ndryshimet të rëndësishme dhe të shpeshta në vlerën e drejtë, prandaj kanë nevojë për rivlerësim vjetor. Të tilla rivlerësime të shpeshta janë të panevojshme për zëra të aktiveve afatgjata materiale me ndryshime jo të rëndësishme në vlerën e drejtë. Në vend të tyre mund të jetë e nevojshme të rivlerësohet zëri vetëm çdo tre ose pesë vjet.

35 Kur një zë i klasës toka, ndërtesa, makineri e pajisje rivlerësohet, i gjithë amortizimi i akumuluar vlera neto kontabël e atij aktivi rregullohet sipas vlerës së rivlerësuar. Në datën e rivlerësimit, aktivi trajtohet sipas një nga mënyrave të mëposhtme:

(a) vlera kontabël bruto rregullohet në mënyrë të tillë që të jetë konsistente me rivlerësimin e vlerës kontabël neto të aktivit. Për shembull vlera e mbartur bruto mund të rivlerësohet duke i'u referuar të dhënave të vëzhguara të tregut ose mund të rivlerësohet në mënyrë proporcionale me ndryshimin e vlerës neto kontabël. Amortizimi i akumuluar në ditën e rivlerësimit rregullohet për të balancuar diferencën midis vlerës së mbartur bruto dhe vlerës neto kontabël të aktivit pas marrjes në konsideratë të humbjeve të akumuluara nga zhvlerësimi; ose

(b) amortizimi i akumuluar eliminohet tek vlera e mbartur bruto e aktivit.

Shuma e rregullimit të amortizimit të akumuluar formon pjesë të rritjes ose pakësimit të vlerës kontabël (neto) e cila trajtohet në përputhje me paragrafët 39 dhe 40.

36 **Nëse një zë i aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) rivlerësohet, duhet të rivlerësohet e gjithë kategoria e aktiveve afatgjata materiale së cilës i përket aktivi.**

37 Një kategori e aktiveve afatgjata materiale është një grupim i aktiveve me natyrë dhe përdorim të ngjashëm në operacionet e një njësie ekonomike. Shembuj të kategorive të veçanta janë si vijon:

(a) toka;

(b) toka dhe ndërtesa;

 © Fondacioni i SNRF-ve

(c) makineri;

(d) anije;

(e) avion;

(f) automjete;

(g) mobilje dhe instalime;

(h) pajisje zyre; dhe

(i) bimët bartëse.

38 Zërat brenda një kategorie të aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në të njëjtën kohë për të shmangur rivlerësimin e diferencuar (sipas dëshirës) të aktiveve dhe raportimin në pasqyrat financiare të shumave që janë një përzierje e kostove dhe vlerave në data të ndryshme. Megjithatë një kategori aktivesh mund të rivlerësohet mbi baza pasuese nëse rivlerësimi i kategorisë së aktiveve përfundon brenda një periudhe të shkurtër dhe nëse rivlerësimet përditësohen.

39 Nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe akumulohet tek kapitalet e veta me titullin tepricë rivlerësimi. Megjithatë, rritja njihet në fitim ose humbje për aq sa kjo mbulon uljen e rivlerësimit e të njëjtit aktiv të njohur më parë në fitim ose humbje.

40 Nëse vlera kontabël (neto) e një aktivi ulet si rezultat i një rivlerësimi, ulja njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, ulja do të njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për aq sa kjo mbulon çdo tepricë kreditore ekzistuese në tepricën e rivlerësimit në lidhje me atë aktiv. Rënia që njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, zvogëlon shumën e akumuluar në kapital në zërin, tepricë nga rivlerësimi.

41 Teprica e rivlerësimit e përfshirë në kapitalin neto në lidhje me një zë të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) mund të transferohet drejtpërdrejt tek fitimi i pashpërndarë nëse aktivi nuk njihet (çregjistrohet). Kjo mund të përfshijë transferimin e gjithë tepricës nëse aktivi tërhiqet ose nxirret nga përdorimi. Megjithatë, një pjesë e mbivlerës mund të transferohet kur aktivi përdoret nga njësia ekonomike. Në një rast të tillë madhësia e tepricës së transferuar do të jetë diferenca mes amortizimit të bazuar në vlerën kontabël (neto) të rivlerësuar të aktivit dhe amortizimin e bazuar në koston fillestare të aktivit. Transferimi nga teprica (mbivlera) e rivlerësimi tek fitimi i pashpërndarë nuk bëhet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

42 Efektet në tatimin mbi të ardhurat, nëse ka, që vijnë nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) njihen dhe paraqiten në përputhje me SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat.*

Amortizimi

43 Çdo pjesë e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) me një kosto të rëndësishme në lidhje me koston totale të zërit do të amortizohet veçmas.

44 Njësia ekonomike shpërndan shumat e njohura më parë në lidhje me një zë të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) në pjesët e rëndësishme të tij dhe amortizon veçmas çdo pjesë të tillë. Për shembull mund të jetë e përshtatshme të amortizohen veçmas struktura e avionit dhe motorët e tij, pavarësisht nëse zotërohet apo është siguruar nëpërmjet qirasë financiare. Në mënyrë të ngjashme, nëse një njësi ekonomike blen aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), që janë subjekt i një qiraje operative në të cilën njësia ekonomike është qiradhënësi, mund të jetë e përshtatshme të amortizojë në mënyrë të veçantë shumat e reflektuara në kostot e atij aktivi që i atribuohen termave të favorshme apo të disfavorshme të qirasë në raport me tregun.

45 Një pjesë e rëndësishme e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) mund të ketë jetë të dobishme dhe metodë amortizimi të njëjtë si jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit e pjesëve të tjera të rëndësishme të të njëjtit zë. Pjesë të tilla mund të grupohen për të përcaktuar madhësinë e amortizimit.

46 Në madhësinë që një njësi ekonomike amortizon veçmas disa pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), ajo amortizon veçmas edhe pjesën e mbetur të zërit. Pjesa e mbetur përbëhet nga pjesë të zërit të cilat janë të parëndësishme veçmas nga njëra tjetra. Nëse një njësi ekonomike ka pritshmëri të ndryshme për këto pjesë, mund të jenë të nevojshme teknika përafrimi për të amortizuar pjesën e mbetur në një mënyrë që përfaqëson besnikërisht tiparet e konsumit dhe /ose jetës së dobishme të pjesëve të tij.

47 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë të amortizojë veçmas pjesë të një zëri që nuk kanë kosto të rëndësishme në lidhje me koston totale të zërit.

48 **Madhësia e amortizimit për çdo periudhë duhet të njihet në fitim ose humbje me përjashtim të rastit kur përfshihet në vlerën kontabël (neto) të një aktivi tjetër.**

49 Madhësia e amortizimit për periudhën zakonisht njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, ndonjëherë përfitimet ekonomike në të ardhmen të trupëzuara në një aktiv përthithen në prodhimin e aktiveve të tjera. Në këtë rast, shpenzimi për amortizimin përbën pjesë të kostos të një aktivi tjetër dhe përfshihet në vlerën e tij kontabël (neto). Për shembull amortizimi i makinerive dhe pajisjeve prodhuese përfshihet në kostot e transformimit të inventarëve (shih SNK 2). Në mënyrë të ngjashme amortizimi i aktiveve afatgjatë materiale (ndërtesa, makineri e pajisje) të përdorura për zhvillimin e aktiviteteve mund të përfshihet në koston e një aktivi jo-material të njohur në përputhje me SNK 38 *Aktivet jo-materiale.*

Shuma e amortizueshme dhe periudha e amortizimit

50 **Shuma e amortizueshme e një aktivi do të shpërndahet mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme.**

51 **Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e një aktivi do të rishihet të paktën çdo fund viti financiar dhe nëse pritshmëria ndryshon nga parashikimet e mëparshme, ndryshimi(et) do të trajtohet si ndryshim në vlerësimet kontabël në përputhje me SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.***

52 Amortizimi njihet edhe nëse vlera e drejtë e aktivit tejkalon vlerën kontabël (neto) të tij, për sa kohë që vlera e mbetur e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël (neto) të tij. Riparimi dhe mirëmbajtja e një aktivi nuk eliminon nevojën për ta amortizuar atë.

53 Shuma e amortizueshme e një aktivi përcaktohet pasi zbritet vlera e tij e mbetur. Shpesh në praktikë vlera e mbetur e një aktivi është e parëndësishme dhe prandaj jo materiale në llogaritjen e shumës së amortizueshme.

54 Vlera e mbetur e një aktivi mund të rritet sa një shumë e barabartë ose më e madhe se vlera kontabël (neto) e aktivit. Nëse ndodh kjo, shpenzimi për amortizimin e aktivit është zero përveçse dhe derisa vlera e tij e mbetur të ulet më pas deri në një shumë më të ulët se vlera kontabël (neto) e aktivit.

55 Amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, d.m.th. kur ai është në vendin dhe kushtet e nevojshme për të që të ketë mundësi të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi. Amortizimi i aktivit ndërpritet në datën më të parë mes datës që aktivi klasifikohet si i mbajtur për shitje (ose përfshirë në një grup për t'u nxjerrë jashtë përdorimit që është klasifikuar i mbajtur për shitje) në përputhje me SNRF 5 dhe datës që aktivi çregjistrohet. Prandaj amortizimi nuk ndërpritet nëse aktivi bëhet i përdorshëm ose tërhiqet përdorimi aktiv përveçse kur aktiv është plotësisht i amortizuar. Megjithatë, sipas metodave të përdorimit për llogaritjen e amortizimit, amortizimi mund të jetë zero, ndërsa nuk ka prodhim.

56 Përfitimet ekonomike të ardhshme të trupëzuara në një aktiv konsumohen në një njësi ekonomike parimisht përmes përdorimit të tij. Megjithatë faktorë të tjerë si amortizimi teknik ose moral dhe konsumimi ndërsa një aktiv është i gatshëm për përdorim, shpesh rezulton në pakësimin e përfitimeve ekonomike që mund të merreshin nga aktivi. Për pasojë të gjithë faktorët në vijim merren në konsideratë në përcaktimin e jetës së dobishme të një aktivi:

(a) përdorimi i pritshëm i aktivit. Përdorimi vlerësohet duke i'u referuar kapaciteteve të pritshme të aktivit ose prodhimit fizik.

(b) konsumimin fizik të pritshëm, që varet nga faktorë të shfrytëzimit të tillë si numri i ndërrimeve për të cilin aktivi përdoret dhe programin e riparimit dhe të mirëmbajtjes, si dhe kujdesin dhe mirëmbajtjen e aktivit, ndërsa ai nuk punon.

(c) vjetërimin teknik ose tregtar, që rrjedh nga ndryshimet ose përmirësimet në prodhim, ose nga një ndryshim në kërkesën e tregut për produktin apo shërbimin e siguruar nga aktivi. Pakësimet e pritshme të ardhshme në çmimin e shitjes së një zëri të prodhuar duke përdorur një aktiv mund të jenë tregues të amortizimit teknik ose moral të aktivit dhe mund të reflektojnë një pakësim të përfitimeve ekonomike të ardhshme të përfaqësuara nga aktivi.

(d) kufizimet ligjore dhe të ngjashme ndaj përdorimit të aktivit, të tilla si datat e përfundimit të qirave financiare të lidhura me të.

57 Jeta e dobishme e një aktivi përcaktohet në termat e dobishmërisë së pritshme të aktivit për njësinë ekonomike. Politika e menaxhimit të aktiveve të njësisë ekonomike mund të përfshijë nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve pas një kohe të caktuar ose pas konsumit të një pjese të caktuar të përfitimeve ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktiv. Prandaj jeta e dobishme e një aktivi mund të jetë më e shkurtër sesa jeta ekonomike e tij. Vlerësimi i jetës së dobishme të aktivit është çështje gjykimi bazuar në eksperiencën e njësisë ekonomike me aktive të ngjashme.

 © Fondacioni i SNRF-ve

58 Toka dhe ndërtesat janë aktive të ndashme dhe trajtohen veçmas edhe nëse ata janë blerës së bashku. Me pak përjashtime të tilla si guroret dhe vendet e përdorura për mbushje, toka ka jetë të dobishme të pakufizuar dhe prandaj nuk amortizohet. Ndërtesat kanë jetë të dobishme të kufizuar dhe prandaj janë aktive të amortizueshme. Një rritje në vlerën e tokës mbi të cilën qëndron një ndërtesë nuk ndikon përcaktimin e shumës së amortizueshme të ndërtesës.

59 Nëse kosto e tokës përfshin kostot për zbërthimin, heqjen dhe restaurimin e vendit, kjo pjesë e aktivit tokë është e amortizueshme përgjatë periudhës së përfitimeve të marra nga pësimi (kryerja) i këtyre kostove. Në disa raste vetë toka mund të ketë jetë të dobishme të kufizuar, dhe në këtë rast ajo amortizohet në një mënyrë që pasqyron përfitimet që do të merren prej saj.

Metoda e amortizimit

60 Metoda e amortizimit e përdorur duhet të pasqyrojë modelin sipas të cilit njësia ekonomike pret të konsumojë përfitimet ekonomike të ardhshme nga aktivi.

61 Metoda e amortizimit e përdorur për një aktiv do të rishikohet të paktën çdo fund-viti financiar dhe nëse ka një ndryshim të rëndësishëm në tiparin e pritshëm të konsumit të përfitimeve ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktiv, metoda duhet të ndryshohet për të pasqyruar tiparin e ndryshuar. Një ndryshim i tillë do të trajtohet si ndryshim në vlerësimin kontabël në përputhje me SNK 8.

62 Mund të përdoren disa metoda amortizimi për të shpërndarë shumën e amortizueshme të një aktivi mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Këto metoda përfshijnë metodën lineare, metodën e zvogëlimit te tepricës dhe metodën e njësive të prodhimit. Amortizimi lineare sjell një ngarkesë konstante gjatë jetës së dobishme nëse vlera e mbetur e aktivit nuk ndryshon. Metoda e zvogëlimit të tepricës sjell një ngarkesë rënëse përgjatë jetës së dobishme. Metoda e njësive të prodhimit sjell një ngarkesë të bazuar në përdorimin ose prodhimin (output) e pritshëm. Njësia ekonomike zgjedh metodën që pasqyron më mirë tiparin e pritshëm të konsumit të përfitimeve ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktiv. Kjo metodë zbatohet në mënyrë të qëndrueshme nga periudha në periudhë përveç se kur ka një ndryshim në tiparin e pritshëm të konsumit të këtyre përfitimeve ekonomike të ardhshme.

62A Një metodë amortizimi e cila bazohet në të ardhurat e gjeneruara nga një aktivitet që përfshin përdorimin e aktivit nuk është e përshtatshme. Zakonisht të ardhurat e gjeneruara nga një aktivitet që përfshin përdorimin e aktivit reflektojnë faktorë të tjerë të ndryshëm nga konsumi i përfitimeve ekonomike të aktivit. Për shembull, e ardhura ndikohet nga inpute dhe procese të tjera, aktivitet e shitjes dhe ndryshimet në vëllimin e shitjeve dhe në çmime. Përbërësi çmim i të ardhurave mund të ndikohet nga inflacioni, që nuk ka të bëjë aspak me mënyrën sesi konsumohet aktivi.

Zhvlerësimi

63 Për të përcaktuar nëse një zë i aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) zhvlerësohet, një njësi ekonomike zbaton SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve.* Ky Standard shpjegon sesi një njësi ekonomike rishikon vlerën kontabël (neto) të aktiveve të saj, sesi përcakton shumën e rikuperueshme të një aktivi dhe nëse njeh, ose anulon njohjen, shumën e një humbjeje nga zhvlerësimi.

64 [Fshirë]

Kompensimi për zhvlerësim

65 Kompensimi nga palë të treta për zëra të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të zhvlerësuara, humbura ose të dhëna (nga të cilat është hequr dorë) do të përfshihen në fitim ose humbje në kohën kur kompensimi bëhet i arkëtueshëm.

66 Zhvlerësimet ose humbjet e zërave të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), të lidhura me kërkesat për ose pagesat e kompensimeve nga palë të treta dhe çdo blerje ose ndërtim i mëpasshëm i aktiveve zëvendësuese janë ngjarje ekonomike të veçanta dhe trajtohen veçmas si vijon:

(a) zhvlerësimet e zërave të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesat, makineritë e pajisjet) njihen në përputhje me SNK 36;

(b) mosnjohja e zërave të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të tërhequra ose nxjerra nga përdorimi përcaktohet në përputhje me këtë Standard;

(c) kompensimi nga palë të treta për zëra të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të zhvlerësuara, humbura ose të dhëna (nga të cilat është hequr dorë) do të përfshihen në përcaktimin e fitimit ose humbjes në kohën kur kompensimi bëhet i arkëtueshëm; dhe

(d) kosto e zërave të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të rikrijuara, blerë ose ndërtuara si zëvendësim përcaktohet në përputhje me këtë Standard.

Çregjistrimi

67 Vlera kontabël (neto) e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) nuk do të njihet:

(a) kur nxirret jashtë përdorimit; ose

(b) kur nuk priten më përfitime ekonomike në të ardhmen nga përdorimi i tij ose shitja.

68 Fitimi ose humbja që vjen nga mosnjohja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) do të përfshihet në fitim ose humbje nëse zëri nuk njihet (përveç se kur SNRF 16 *Qiratë* kërkon të veprohet ndryshe lidhur me shitjen dhe shitje - marrje me qira). Fitimet nuk duhet të klasifikohen si të ardhura.

68A Megjithatë, një njësi ekonomike që, në rrjedhën e aktiviteteve të saj të zakonshme, në mënyrë rutinë shet elementë të aktiveve afatgjata materiale që i ka mbajtur për qira tek të tjerët, do të transferojë këto aktive tek grupi i inventarëve me vlerën kontabël neto të tyre kur ato pushojnë së dhëni me qira dhe mbahen për t'u shitur. Shumat nga shitja e aktiveve të tilla do të njihen si të ardhura në përputhje me SNRF 15 *Të Ardhurat nga kontratat me klientët.* SNRF 5 nuk aplikohet kur aktivet që janë mbajtur për shitje në rrjedhën normale të biznesit janë transferuar në inventar.

69 Nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë material mund të ndodhë në disa mënyra (p.sh. duke i shitur, duke marrë një qira financiare, ose duke i dhuruar). Data e nxjerrjes jashtë përdorimit të një zëri të aktiveve afatgjata materiale është data kur marrësi merr kontrollin e atij zëri në përputhje me kërkesat në SNRF 15 për përcaktimin se kur përmbushet një detyrim i performancës. SNRF 16 zbatohet për nxjerrjet jashtë përdorimit nga një shitje dhe kthim qiraje.

70 Nëse sipas parimit të njohjes në paragrafin 7, një njësi ekonomike njeh në vlerën kontabël (neto) të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), koston e zëvendësimit të një pjese të zërit, atëherë ajo nuk njeh (çregjistron) vlerën kontabël (neto) të pjesë së zëvendësuar pavarësisht nëse pjesa e zëvendësuar është amortizuar veçmas. Nëse praktikisht nuk është e mundur për një njësi ekonomike të përcaktojë vlerën kontabël (neto) të pjesës së zëvendësuar, ajo mund të përdorë koston e zëvendësimit si një tregues të kostos së kësaj pjese në kohën kur ajo është blerë ose ndërtuar.

71 Fitimi ose humbja që vjen nga mosnjohja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) do të përcaktohet si diferenca mes shumës neto nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi, nëse ka, dhe vlerës kontabël (neto) të zërit.

72 Shuma e konsiderueshme që përfshihet në fitimin ose humbjen që vjen nga mosnjohja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale dhe pajisjeve të përcaktohet në përputhje me kërkesat për përcaktimin e çmimit të transaksionit në paragrafët 47-72 të SNRF 15. Ndryshimet e mëpasshme në shumën e vlerësuar të konsideratës të përfshirë në fitim ose humbje do të trajtohen në përputhje me kërkesat për ndryshim në çmimin e transaksionit të SNRF 15.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

73 Në pasqyrat financiare do të jepet informacion shpjegues për çdo kategori të aktiveve afatgjata materiale:

(a) bazat e matjes të përdoruar për përcaktimin e vlerës kontabël bruto;

(b) metodat e amortizimit të përdorura;

(c) jetët e dobishme ose normat e amortizimit të përdorura;

(d) vlerën kontabël bruto dhe çdo amortizim të akumuluar (të mbledhur me humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi) në fillim dhe në fund të periudhës; dhe

(e) rakordimin e vlerës kontabël (neto)në fillim dhe në fund të periudhës duke treguar:

(i) shtesat;

(ii) aktivet e klasifikuara si të mbajtura për shitje ose të përfshira në një grup të nxjerrë jashtë përdorimit, i klasifikuar si i mbajtur për shitje në përputhje me SNRF 5 dhe nxjerrjet e tjera jashtë përdorimit;

(iii) blerjet përmes kombinimeve të biznesit;

 © Fondacioni i SNRF-ve

(iv) rritjet dhe uljet që rezultojnë nga rivlerësimet sipas paragrafëve 31, 39 dhe 40 dhe nga humbjet e zhvlerësimit të njohura ose të anulluara drejtpërdrejt në kapitalet e veta në përputhje me SNK 36;

(v) humbjet nga zhvlerësimi të njohura në fitim ose humbje në përputhje me SNK 36;

(vi) humbjet nga zhvlerësimi të anulluara në fitim ose humbje në përputhje me SNK 36;

(vii) amortizimin;

(viii) diferencat neto nga këmbimi që vijnë nga konvertimi i pasqyrave financiare në një monedhë paraqitjeje të ndryshme, përfshirë konvertimin e operacioneve jashtë vendit në monedhën e paraqitjes të njësisë ekonomike raportuese; dhe

(ix) ndryshime të tjera.

74 Në pasqyrat financiare do të jepet informacion shpjegues për:

(a) ekzistencën dhe madhësinë e kufizimeve mbi titujt dhe aktivet afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të përdorura si garanci për detyrime;

(b) shumën e shpenzimeve të njohura në vlerën kontabël (neto) të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) gjatë procesit të ndërtimit të tij; dhe

(c) shumën e angazhimeve kontraktuale për blerjen e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).

74A Nëse nuk është paraqitur veçmas në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrat financiare duhet gjithashtu të shtjellojnë:

(a) shumën e kompensimit e përfituar nga palët e treta për zërat e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) që janë dëmtuar, humbur ose hequr nga përdorimi dhe që janë përfshirë në fitim ose humbje; dhe

(b) shumat e të ardhurave nga shitja dhe kostos së përfshirë në fitim ose humbje në përputhje me paragrafin 20A që kanë të bëjnë me zërat e prodhuar që nuk janë rezultat i aktivitetit të zakonshëm të njësisë ekonomike dhe cilat zëra të pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse përfshijnë këto të ardhura dhe kosto.

75 Zgjedhja e metodës së amortizimit dhe vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve është çështje gjykimi. Prandaj dhënia e informacioneve shpjeguese për metodat e përdorura dhe vlerësimet e jetëve të dobishme ose të normave të amortizimit, u siguron përdoruesve të pasqyrave financiare informacion që i lejon ata të shqyrtojnë politikat e zgjedhura nga drejtimi dhe mundëson krahasimin me njësi të tjera ekonomike. Për arsye të ngjashme është e nevojshme të jepet informacion shpjegues për:

(a) amortizimin, të njohur në fitim ose humbje ose si pjesë e kostos së aktiveve të tjera gjatë një periudhe; dhe

(b) amortizimin e akumuluar në fund të periudhës.

76 Në përputhje me SNK 8 një njësi ekonomike jep informacion shpjegues për natyrën dhe efektin e një ndryshimi në vlerësimin kontabël që ka efekt në periudhën aktuale ose pritet të ketë efekt në periudhat e mëpasshme. Dhënia e këtyre informacioneve shpjeguese për aktivet afatgjata materiale mund vijë nga ndryshimet në lidhje me:

(a) vlerat e mbetura;

(b) kostot e vlerësuara të zbërthimit, heqjes ose rikrijimit të zërave të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje);

(c) jetët e dobishme; dhe

(d) metodat e amortizimit.

77 Nëse zërat e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) paraqiten për shumat e rivlerësuara, duhet të jepet informacioni shpjegues siç kërkohet nga SNRF 13:

(a) datën e hyrjes në fuqi të rivlerësimit;

(b) nëse është përfshirë një vlerësues i pavarur;

(c)–(d) [fshirë]

(e) për secilën kategori të rivlerësuar të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), vlerën kontabël neto që do të ishte njohur sikur aktivet të ishin njohur duke përdorur modelin e kostos; dhe

(f) tepricën e rivlerësimit, duke treguar ndryshimin për periudhën dhe çdo kufizim në shpërndarjen e tepricës tek aksionarët.

78 Në përputhje me SNK 36 njësia ekonomike jep informacione shpjeguese për aktivet afatgjata materiale të zhvlerësuara, si shtesë të informacionit të kërkuar nga paragrafi 73(e)(iv)-(vi).

79 I rëndësishëm për nevojat e përdoruesve të pasqyrave financiare mund të jetë edhe informacioni në vijim:

(a) vlera kontabël (neto) e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) përkohësisht gati për përdorim;

(b) vlerën kontabël bruto të çdo aktivi afatgjatë material (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) plotësisht të amortizuar që është ende në përdorim;

(c) vlerën kontabël (neto) të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të tërhequra nga përdorimi aktiv dhe jo të klasifikuara si të mbajtura për shitje në përputhje me SNRF 5; dhe

(d) nëse është përdorur modeli i kostos, vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) nëse kjo është e ndryshme materialisht nga vlera kontabël (neto).

Prandaj njësitë ekonomike inkurajohen të japin informacion shpjegues për këto shuma.

Periudhat kalimtare

80 Kërkesat në paragrafët 24–26 lidhur me matjen fillestare të një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të siguruar në një transaksion të këmbimit të aktiveve do të zbatohen në mënyrë prospektive vetëm për transaksione të ardhshme.

80A Paragrafi 35 është ndryshuar nga *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012.* Një njësi ekonomike duhet të aplikojë këtë ndryshim për të gjitha rivlerësimet të njohura në periudhat raportuese që fillojnë më datën e aplikimit fillestar të këtij ndryshimi ose më vonë, dhe për periudhën vjetore pararendëse. Një njësi ekonomike gjithashtu mund të paraqesë informacionin krahasues të rregulluar për çdo periudhë më të hershme, por kjo nuk kërkohet. Në qoftë se një njësi ekonomike prezanton informacion krahasues të pa rregulluar për ndonjë periudhë më të hershme, ajo duhet të identifikojë qartazi që informacioni nuk është i rregulluar, të deklarojë që informacioni është përgatitur mbi baza të ndryshme, dhe t'i shpjegojë këto baza.

80B Nëse në periudhën e raportimit *Bujqësia: Bimët bartëse* (Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 41) zbatohet për herë të parë, një njësi ekonomike nuk ka nevojë të japë informacionin shpjegues sasior të kërkuar nga paragrafi 28(f) i SNK 8 për periudhën aktuale. Megjithatë, një njësi ekonomike do të paraqesë informacionin shpjegues sasior të kërkuar nga paragrafi 28(f) i SNK 8 për çdo periudhë të mëparshme të paraqitur.

80C Në pasqyrat financiare të periudhës raportuese, kur një njësi ekonomike zbaton për herë të parë *Bujqësia: Bimët bartëse*(Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 41) ajo mund të zgjedhë të masë një zë të kategorisë bimë bartëse me vlerën e drejtë në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur dhe mund ta përdorë këtë vlerë të drejtë si koston e supozuar të zërit në atë datë. Çdo diferencë mes vlerës kontabël neto të mëparshme dhe vlerës së drejtë do të njihet në çeljen e fitimeve të pashpërndara në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur.

80D *Aktivet afatgjata materiale* (*toka, ndërtesa, makineri e pajisje) — Të ardhurat para fillimit të përdorimit*, e publikuar në maj 2020, ka ndryshuar paragrafët 17 dhe 74 dhe ka shtuar paragrafët 20A dhe 74A. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive, por vetëm për zëra të aktiveve afatgjata materiale (toka ndërtesa, makineri e pajisje) që janë sjellë në vendndodhjen dhe gjendjen e nevojshme të tillë që të jenë të afta të operojnë në mënyrën e parashikuar prej drejtimit të njësisë ekonomike, në datën e fillimit të periudhës më të hershme të paraqitur në pasqyrat financiare, në të cilat njësia ekonomike ka zbatuar për herë të parë këto ndryshime. Njësia ekonomike do të njohë efektin e akumuluar të zbatimit për herë të parë të këtyre ndryshimeve si një rregullim të tepricës së çeljes të fitimeve të pa shpërndara (ose në një element tjetër të kapitalit neto, që është më i përshtatshëm) në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur.

Data e hyrjes në fuqi

81 Njësia ekonomike do të zbatojë këtë standard për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

 © Fondacioni i SNRF-ve

81A Njësia ekonomike zbaton ndryshimet në paragrafin 3 për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2006. Nëqoftëse njësia ekonomike zbaton SNRF 6 në një periudhë të mëparshme, këto ndryshime zbatohen për atë periudhë të mëparshme.

81B SNK 1 *Paraqitja e pasqyrave financiare* (rishikuar në 2007) ka ndryshuar terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Përveç kësaj, ajo ka ndryshuar paragrafët 39, 40 dhe 73(e)(iv). Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 janar 2009 ose më pas. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.[1]

81C SNRF 3 *Kombinimi i bizneseve* (rishikuar në 2008) ka ndryshuar paragrafin 44. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2009. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNRF 3 (rishikuar në 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.

81D Paragrafët 6 dhe 69 janë ndryshuar dhe paragrafi 68A është shtuar nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2008. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 janar 2009 ose më pas. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt dhe në të njëjtën kohë të zbatojë ndryshimet e lidhura me SNK 7 *Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare.*

81E Paragrafi 5 është ndryshuar sipas *Përmirësimeve në SNRF-të* të publikuara në maj 2008. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2009. Zbatimi më herët është i lejuar nëse një njësi ekonomike zbaton edhe ndryshimet në paragrafët 8, 9, 22, 48, 53, 53A, 53B, 54, 57 dhe 85B të SNK 40 në të njëjtën kohë. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

81F SNRF 13, publikuar në maj 2011, ka ndryshuar përkufizimin e vlerës së drejtë në paragrafin 6, ka ndryshuar paragrafët 26, 35 dhe 77 dhe ka fshirë paragrafët 32 dhe 33. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 13.

81G *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2009-2011,* të publikuara në maj 2012, kanë ndryshuar paragrafin 8. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet* [2] për periudhat që fillojnë në 1 janar 2013 e më pas. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

81H *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012,* të publikuara në dhjetor 2013, paragrafi 35 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 80A. Një njësi ekonomike do të aplikojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 korrik 2014. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

81I *Sqarim mbi metodat e pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit* (Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 38), i publikuar në maj 2014, ndryshoi paragrafin 56 dhe shtoi paragrafin 62A. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016 e më pas. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

81J SNRF 15 *Të ardhurat nga kontratat me klientët*, i publikuar në maj 2014, ndryshoi paragrafët 68A, 69 dhe 72. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 15.

81K *Bujqësia: Bimët bartëse* (Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41), i publikuar në qershor 2014, ndryshoi paragrafët 3, 6 dhe 37 dhe shtoi paragrafët 22A dhe 80B–80C. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016 e në vijim. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8, me përjashtim të specifikimeve në paragrafin 80C.

81L SNRF 16, i publikuar në janar 2016, fshiu paragrafët 4 dhe 27 dhe ndryshoi paragrafët 5, 10, 44 dhe 68–69. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

81M SNRF 17, i publikuar në maj 2017 shtoi paragrafët 29A dhe 29B. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 17.

81N *Aktivet afatgjata materiale* (*toka, ndërtesa, makineri e pajisje) — Të ardhurat para fillimit të përdorimit,* e publikuar në maj 2020, ka ndryshuar paragrafët 17 dhe 74 dhe ka shtuar paragrafët 20A, 74A dhe 80D. Një

---

[1] Në prill 2024, BSNK publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* dhe mbarti këto kërkesa të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* tek SNRF 18.

[2] Kur publikoi SNRF 18, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8 në *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*.

njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar 2022 ose pas kësaj date. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

81O SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* i publikuar në prill 2024 ndryshoi paragrafin 51. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

Shfuqizimi deklaratave të tjera

82 Ky Standard zëvendëson SNK 16 *Aktivet afatgjata materiale* (rishikuar në 1998).

83 Ky Standard zëvendëson Interpretimet e mëposhtme:

(a) KIS-6 *Kostot e modifikimit të programeve kompjuterike ekzistuese*;

(b) KIS-14 *Aktivet afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)—Kompensimi për zhvlerësim ose humbjen e zërave;* dhe

(c) KIS-23 *Aktivet afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)—Kostot e inspektimit ose kontrollit kryesor.*

 © Fondacioni i SNRF-ve